



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT-VENDIM

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2021 DHE
PBA PËRFUNDIMTARE 2021-2023**

Kryetari i Bashkisë, pasi u njoh me Relacionin "Mbi miratimin e buxhetit të bashkisë Berat të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023", në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 8, 9, 41, 54/dh, 64/c, ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 6, pika ç, d, 39.40 41, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023", Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të qeverisjes vendore", ligjit nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", ligjit 45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 65, pika 1, Udhëzimin e Ministrisë së Brëndshme nr. 2941, datë 20/11/2020 "Mbi zbatimin e ligjit 45/2019" Për mbrojtjen civile", VKM nr.165, datë 02.03.2016, "Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijeve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësisve të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, VKM nr.929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit tëveçantë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.60, datë 18.12.2019, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Berat" dhe shkresës së Ministrisë së Financave, "Dërgohet për njoftim transfera e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2020",

VENDOSI:

1.Miratimin e treguesive të buxhetit për vitin 2021, si më poshtë :

Të dhënat në /000 lekë

A - Të ardhurat gjithsej (I +II).....	1,065,417
I - Të ardhurat e buxhetit te pavarur.....	500,173
- Te ardhurat vendore (Plan i vitit 2020).....	500,173
II - Transfera gjithsej.....	565,244

- Transferata e pa kushtezuar 298,960
- Transferata sektoriale & specifike266,283

B - Shpenzimet gjithsej.....1,065,417

- I- Shpenzime personeli521,158
- II- Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes373,616
- III - Investime gjithsej170,643
 - Nga të ardhurat e Bashkisë168,704
 - Nga transferata specifike 1,939

2. Miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Berat për vitin 2021, gjithsej 724 punonjës nga të cilët:

Financuar me fonde nga "Te ardhurat e veta" 421 punonjës.

Financuar me fonde nga "Transferata sektoriale" 303 punonjës.

3. Miratimin e planit të të ardhurave për periudhën 2021-2023, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Miratimin e planit financiar të Bashkisë Berat, për periudhën 2021-2023, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.

5. Të miratojë detajimin e buxhetit për vitin 2021, si dhe periudhën 2021-2023, të shpenzimeve korrente dhe kapitale sipas programeve, tabela pjesë përbërëse e këtij vendimi.

6. Miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të këshillit artistik në masën 4 500 lekë në muaj, kur zhvillojnë mbledhje, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore.

7. Miratimin e shpërbimit mujor të kryetarëve të fshatrave sipas pikës 16 të VKM nr.165, datë 02.03.2016, i ndryshuar, në masën 10% të pagës së administratorëve të njësive administrative.

8. Miratimin e krijimit të fondit të mbrojtjes civile, në zbatim të nenit 65 pika 1, të ligjit 45/2019 'Për mbrojtjen civile', në masën 4% të totalit të buxhetit vjetor 2021, në shumën 43,010,800 e cila do të sigurohet edhe nga transferata e kushtëzuar e buxhetit të shtetit.

9. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen drejtoritë e bashkisë dhe njësitë shpenzuese në varësi të bashkisë.

10. Vendim hyn në fuqi në datën 1 janar 2021.

KRYETAR

I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA